

## **Konkurs për poziten: MENAXHER/E I/E FINANCAVE**

[Platforma CiviKos](#) është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike.

### **Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar**

- Së paku diplome Bachelor në Ekonomi apo fusha të ngjashme;
- Përvojë në menaxhim financiar së paku tri vite (e domosdoshme përvoja në sektorin jo-qeveritar);
- Aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e QuickBooks dhe Excel;
- Njohuri dhe përvojë me kornizën ligjore të Kosovës, praktikat më të mira të kontabilitetit dhe procedurat e prokurimit;
- Njohuri për legjislacionin tatimor në Kosovë;
- Përvojë dhe njohuri në menaxhim financiar për projekte të financuara nga USAID, BE, dhe donatorë ndërkombëtarë;
- Aftësi në të folur dhe shkruar në shqip dhe anglisht;
- Përvoje në planifikim financiar;
- Aftësi ndër-personale dhe shkathtësi të bashkëpunoj mirë me organizatat dhe donatorët.

### **Përgjegjësitë kryesore janë:**

- Ekzekutimi i pagesave, pagave, tatimeve në përputhje me procedurat e brendshme dhe legjislacionin tatimor në Kosovë;
- Përgjegjës për planifikim financiar dhe hartim të buxheteve për donator të ndryshëm;
- Përgjegjës për përgatitje të raporteve financiare për projekte të ndryshme në përputhje me kërkesat e donatorëve;
- Të mirëmbajë të gjitha të dhënat financiare të projektit dhe organizatës në tërësi;
- Të organizoj procedurat e prokurimit të projekteve;
- Të ndërmarrë planifikime për financa dhe raportim në bashkëpunim të ngushtë me menaxherët e projekteve;
- Të sigurojë dorëzimin në kohë të raporteve përkatëse.

### **Dokumentet për dorëzim**

1. Një Cv të kandidatit/es
2. Një letër motivuese (1 faqe A4 max) për përvojën dhe motivin për tu bashkuar me ekipin e Platforma CiviKos.

Dokumentet e kërkuara ju mund ti dërgoni deri me 19.05.2022 në email [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net). Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të njoftohen.